



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2022:121113

Datë: 29.08.2024

Numri i dokumentit: 06102748

**Ac.nr.7101/2022**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, gjyqtari individual Hysni Bardheci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Robertina Lekaj, në çështjen përmbartimore të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a, me seli në Prishtinë, rruga “Nënë Tereza”, nr.36, kundër debitorit K.Sh. nga Skenderaj, rruga “...”, me bazë juridike përmbartimore-borxh, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, PPP.nr.122/2020 të datës 12.01.2021, me datë 29.08.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, PPP.nr.122/2020 i datës 12.01.2021, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.122/2020 të datës 12.01.2021, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit K.Sh. nga Skenderaj, Rr. “...”, ashtu që: Në pikën II, ka shfuqizuar pjesërisht urdhrin për lejimi e përmbartimit P.nr.1477/18 dt. 19.12.2018, në shumë prej 1.203.38 euro dhe ka obliguar debitorin K.Sh. nga Skenderaj Rr. “...”, që kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike me seli në Prishtinë, në emër të borxhit për këstin e 18, sipas programit për pagesën e borxhit t’ia paguaj shumën prej 53.05 euro, me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, nga dita e nxjerrjes së këtij aktvendimi e deri në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbartimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbartimore, vërtetimit të gabuar dhe

jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, të pranoj si të bazuar ankesën e kreditorit, ashtu që të ndryshoj aktvendimin e atakuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarrim P.nr.1447/18 i datës 19.12.2018, ose të prishet aktvendimi i atakuar dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur debitori.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm- ekstraktit të verifikuar nga librat e afariste për pagesën e shërbimeve komunale për konsumin e energjisë elektrike në vlerë prej 1.256.43 euro, për periudhën kohore nga data 04.02.2011 e deri me datën 20.03.2013. Përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin me urdhrin P.nr.1447/18 të datës 19.12.2018, ndaj të cilit urdhër debitori ka ushtruar prapësim me datë 14.06.2019, ndërsa kreditori ka ushtruar përgjigje në prapësim me datën 21.06.2019.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, me aktvendimin PPP.nr.106/2019 të datës 11.07.2019, ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit duke lënë në fuqi urdhrin për përmbarrim. Kundër këtij aktvendimi, debitori ka paraqitur ankesë e cila është aprovuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin Ac.nr.513/2020 të datës 17.08.2020, duke e kthyer çështjen në procedim të serishëm në gjykatën e shkallës së parë.

Në rivendosje, gjykata e shkallës së parë duke vepruar konform sugjerimeve të gjykatës ankimore, si dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimin dhe përgjigjes në prapësim ka marr aktvendimin e atakuar duke aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit duke shfuqizuar pjesërisht urdhrin për lejimi e përmbarrimit në shumë prej 1.203.38 euro, ndërsa ka obliguar debitorin që në emër të borxhit kreditorit t'ia paguaj shumën prej 53.05 euro, me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, nga dita e nxjerrjes së këtij aktvendimi e deri në pagesën definitive të detyrimit.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka konstatuar se debitori me rastin e mos pagesës së këstit të 18, ashtu siç është dakorduar me kreditorin në kontratën e datës dt.01.09.2016, dhe nuk ka bërë shkelje të kontratës dhe nuk ka shkelur nenin 3 të kontratës në të cilin parashihet se: “në rast se përfituesi shkakton 3 vonesa të njëpasnjëshme lidhur me pagesat sipas Programit, marrëveshja shkëputet dhe pjesa e pa paguar e borxhit, nëse ka, fshihet dhe pjesa e mbetur e borxhit i rikthehet, përfshirë këtu edhe të gjitha ndëshkimet”, në rastin konkret nuk ka shkaktuar 3 vonesa të njëpasnjëshme por vetëm një vonesë andaj, ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimi të

atakuar. Për mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitave ligjore nga neni 3, 17, 29 par.1.2, dhe par.3, 38, 69, 71, 73, të LPP-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nga provat e të cilat gjinden në shkresat e lëndës, shihet se kreditori dhe debitori, me datë 01.09.2016 kanë lidhur kontratën për pagesën e borxhit, të cilës i është bashkangjitur edhe deklarata mbi dakordimin e borxhit nr.46784, me çka debitori e ka pranuar borxhin total prej 2,344.43 euro, dhe ka arritur marrëveshje me kreditorin që të bëjë pagesën e borxhit në shumë prej 1,141.05 euro, në 18 këste sipas programit të pagesës së borxhit, me qëllim që të përfitojë faljen e borxhit të grumbulluar deri më datë 31.12.2008 në shumë prej 1,203.38 euro, konform Ligjit Nr.05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike. Sipas nenit 3 të kontratës të lidhur ndërmjet palëve parashihet se “në rast se përfituesi shkakton 3 vonesa të njëpasnjëshme lidhur me pagesat sipas Programit, marrëveshja shkëputet dhe pjesa e pa paguar e borxhit, nëse ka, fshihet dhe pjesa e mbetur e borxhit i rikthehet, përfshirë këtu edhe të gjitha ndëshkimet”. Në rastin konkret rezulton se debitori ka paguar 17 këste, nga 18 sa ishin të parapara me kontratë për pagesën e borxhit, me të cilën nuk ka shkaktuar tri vonesa të njëpasnjëshme, siç parashihet me marrëveshje, andaj Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka pranuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke shfuqizuar urdhrin për përmbarrim të kreditorit në shumën prej 1,203.37 euro, si dhe duke urdhëruar debitorin të bëjë pagesën e borxhit në shumë prej 53.05 euro, në emër të kështit të papaguar lidhur me konsumimin e energjisë elektrike.

Kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore, dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjatë vlerësimit të aktvendimit të atakuar Gjykata e Apelit, ka vërejtur se në hyrje dhe në dispozitiv është bërë një gabim teknik lidhur me emrin e kreditorit, mirëpo kjo gjykatë vlerëson se ky gabim teknik nuk ndikon në ligjshmërinë e aktvendimit të atakuar pasi që duke u bazuar në dispozitën e nenin 165 paragrafi 1 të LPK-së, përcaktohet se: “*Gabimet në emra dhe numra, si dhe gabimet tjera në shkrim dhe llogaritje, mungesat në aspektin e formës së aktgjykimit dhe mospajtimi i kopjes me origjinalin e aktgjykimit, i korrigjon gjykata në çdo kohë*”. Në këtë rast

aktvendimi i atakuar duhet të korrigojohet nga gjykata e shkallës së parë sipas detyrës zyrtare apo në bazë të kërkesës së palës që ka interes.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika b) të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Ac.nr.7101/2022, datë 29.08.2024

Gjyqtari,  
Hysni Bardheci